



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

## Kuvendi i Komunës Klinë

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

01Nr 120-41329 /24

Klinë, dt 10.07.2024

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur, më 20.06.2024, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 16:00.

Mbledhjen e udhëhoqi Nënkyrytarja e komunës së Klinës, Marqe Tanushi-Selmanaj, e cila përshëndeti të gjithë anëtarët e KKSB-së dhe prezantoj rendin e ditës.

1. Diskutim për aktivitetet e organizuara nga Drejtoria e Arsimit për maturantët;
2. Prishja e rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm;
3. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror dhe vërvshimet gjatë vitit;
4. Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave.

**Zv.Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Përshëndetje për të gjithë! Si gjithmonë, bashkë me ne është një përfaqësues i stacionit Policor, kurse për procesverbalin dhe rendin e ditës e keni në faqe dhe në email-at e juaj dhe para se të filloj kërkoj falje për Silvian dhe komunitetin serb, sepse përkthyesi, Silvia e di, që nuk është këtu për arsyeshëm, por nëse ka diçka që nuk e kuption, atëherë të asistoj unë aq sa mundem sepse nuk mu duk e arsyeshme që vetëm për përkthyesin të dështoj procesi.

Bashkë me ne është përfaqësuesi i Policisë, toger Besnik Qupeva, zakonisht e kemi edhe drejtorin e Arsimit, por besoj që do të vijë ndërkohë. E kemi planin e ditës që zakonisht temat i marrim nga plani vjetor dhe nëse dikush nga ju ka diçka për të shtuar si pikë shtesë, atëherë mund t'i japim hapësirë tek pika e fundit në të ndryshme. Prosesverbalet i keni në email dhe nëse keni diçka që nuk është në rregull mund ta sqarojmë edhe këtu. Silvia nuk e ka në gjuhen serbe sepse përkthyesi nuk e ka kthyer përgjigjen dhe rendin e kam përkthyer unë vet në ato

mundësitë e mijë dhe e ka shikuar tha që është në rregull, por procesverbalin nuk ka arritur ta punojë më duket për arsyen shëndetësore, sepse nuk e kam informatën. Para se të kaloj te rendi i ditës e kemi Togerin i cili na njofton për ngjarjet që kanë ndodhur në qytetin tonë.

**Toger z. Besnik Qupeva:** E nderuara kryesuese, të nderuar anëtarë, përshëndetje për të gjithë! Sa i përket sigurisë në komunën tonë, stacioni policor në Klinë vazhdimisht është duke punuar në parandalimin dhe zbulimin e veprave penale, policët janë aktiv, nuk pushojnë asnjëherë, në këtë vit puna janë ka reflektuar shumë mirë në statistika, policia asiston vazhdimisht edhe institucionet e tjera në kuadër të komunës për të gjithë ata që kanë nevojë. Lidhur me angazhimet e policisë vlen të ceket që siguria në shkolla këtë vit ka reflektuar pozitivisht; kemi filluar dhe përfunduar vitin shkollor vetëm me 4 incidente dhe atë të natyrës shumë të lehtë, gjë që nuk ka ndodhur më herët. Në qershor ka pasur angazhime të shtuara sepse ka qenë festivali "I këndojmë lirisë" por e mira është sepse gjatë tri netëve të festivalit nuk e kemi pas asnjë incident. Jemi në përfundim të gjashtëmujorit dhe statistikat i prezantojmë në mbledhjen e ardhshme, mirëpo ne i kemi sjellë edhe disa statistika që janë të muajit maj, ku të gjitha statistikat janë pozitive, do të thotë janë në zhvillim pozitiv. Lidhur me rastet që janë iniciuar në stacionin policor të Klinës, në total rastet duke i përfshirë aksidentet dhe rastet penale kemi një rënie për 10% në maj të vitit 2024 në krahasim me majin e vitit 2023, veprat penale të iniciuara kemi rënie për 30%. Zbulueshmëria e veprave penale zakonisht merret në fund të vitit edhe tek aksidentet me lëndime kemi rënie, tek aksidentet me dëme kemi rënie 40%, kemi ngritje të shqiptimit të numrit të tiketave për 30% që realisht është një statistikë shumë e mirë për neve, diçka tjetër nuk kam të them lidhur me statistikat, pasi që tjerat nuk hynë në punë për Këshillin për Siguri në Bashkësi. A ka dikush ndonjë pyetje? Edhe një sqarim po e bëj pasi jam këtu, për rastin e vjedhjes që ka ndodhur në Krushevë të Madhe në kishën ortodokse, nëse nuk e keni marrë informacionin, pasi që Silvia është këtu, rasti është zbuluar, është proceduar me kallëzim penal ndaj personit të dyshuar dhe është në prokurori, ndërsa dy kishat tjera i kemi nën hetim sepse i kemi dy raste te kisha e Zllakuqanit dhe janë nën hetim dhe një rast është i transferuar në komandën qendrore në Prishtinë sepse është në kompetencë të tyre, faleminderit!

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Faleminderit shumë, toger! Këshilli për Siguri në Bashkësi, pikërisht këto tema i trajton. Atëherë kalojmë te pika e parë e rendit të ditës.

#### **Pika 1. Diskutim për aktivitetet e organizuara nga Drejtoria e Arsimit për maturantët.**

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Këtë temë sigurisht që ka pasur ta elaborojë drejtori i Arsimit, megjithatë ne të gjithë jemi pjesë e qytetit, e fshatrave, shkollave ku ne na rrethojnë, personalisht jam edhe pjesë e arsimit, kështu që, mund t'i them disa fjalë. Togeri shumë mirë e tha, se gjatë kësaj periudhe kohore nuk kishte asnjë incident, kjo do të thotë se as në rastin kur nxënësit tanë kanë pasur maturën ose semimaturën, nuk ka paraqitur ndonjë problem të theksuar. Drejtoria e Arsimit, partner të vet të përhershëm e ka policinë, pos

institucionit të lartë që e ka Ministrinë e Arsimit, ka FSK-në, KFOR-in, ka të gjitha organizatat, institucionet që japid siguri dhe bashkëpunon shumë mirë me to, megjithatë, ata para çdo aktiviteti para se fëmijët të dalin në ekskursione, mandej ato parakalimet që i bëjnë maturantët gjithmonë janë përcjellë nga policia dhe nuk kemi pasur ndonjë rast që ka shkaktuar problem ose që e ka marrë vëmendjen e qytetarëve apo ka rrezikuar jetën e qoftë nxënësve, mësimdhënësve apo qoftë qytetarëve. Nëse dikush ka diçka në këtë pikë që na ka ikur dhe nuk e kemi ndonjë informatë, le të urdhërojë!

**Toger, z. Besnik Qupeva:** Sa i përket policisë, kuptohet që ka qenë një dinamikë shumë e madhe këta muajt e fundit. Gjithmonë kur kemi të bëjmë me maturantët dalin pak jashtë kornizave ligjore, mund të them shkojnë më shumë nga ato kundërvajtëse por janë menaxhuar mirë sepse të rinjtë tanë veçse duhet t'i frenojmë në aspektin ligjor, duhet edhe t'i përkrahim, sepse janë duke e përfunduar një vit shkollor, e ndjejnë veten pak më të rritur por kanë qenë të menaxhueshëm.

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Faleminderit shumë! Drejtoria e Arsimit e luan rolin kyç në edukimin, në parandalimin dhe në vetëdijesimin e qytetarëve të rinj, po i quaj në këtë formë të fëmijëve, nxënësve, adolescentëve, kështu që, më vjen mirë që gjithçka ka shkuar në mënyrën më të mirë të mundshme.

## **Pika 2. Prishja e rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm.**

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Lokalet e natës shpesh janë vendet ku ndodhin shkeljet e rendit dhe qetësisë. Për shkak të sjelljeve të papërgjegjshme të individëve të caktuar dhe për të adresuar këtë problem janë të nevojshme disa masa që jam shumë e sigurt që këto masa i aplikojnë edhe stacioni policor dhe organet tjera të sigurisë. Forcimi i pranisë policore, rritja e pranisë së policisë në zonat ku ndodhen lokalet e natës për të parandaluar incidentet dhe për të ndërhyrë më shpejt në ndonjë rast të shkeljeve, pra, ajo që kërkohet është për vendet që kalojnë orën 22:00 dhe e dimë që ka grumbullime të shumta dhe gjithmonë është kërkuar dhe është vërejtur që ka prani të policisë për të qenë më të shpejtë, më të qasshëm te vendi ku mund të ndodhë, sepse kur të ndodhë, atëherë është problem. Siguria private në qytetin tonë dhe në qytete tjera nuk e di se sa është por është e paraparë sipas rregullores që lokalet e natës duhet të sigurojnë personel sigurie të trajnuar mirë për të menaxhuar situatën problematike dhe për të siguruar rendin brenda ambienteve. Kjo nuk shkon përmes komunës apo policisë, por lokalet me siguri që e kanë atë strukturën e vet përgatitore, kanë persona që kujdesen, qoftë edhe pronari sepse ata janë vetë të organizuar ose paguajnë dikë, me rëndësi është që aty brenda mos të ketë probleme dhe të jenë të siguruar nga problemet që mund të shkaktohen, sepse kuptohet që lokalet e natës nuk konsumojnë vetëm ujë, për këtë arsyе duhet të kemi kujdes. Mandej është që, jo

shumë shpesh ndodhë, është kampanja e ndërgjegjësimit, fushat për të ndërgjegjësuar rreth rëndësise të sjelljeve të përgjegjshme në vendet publike dhe efektet negative të sjelljeve të papërgjegjshme. Ne nuk mund t'i marrim personat që udhëheqin bizneset, t'i përgatisim ose t'i dërgojmë në ndonjë lloj trajnimi ndërgjegjësimi, mirëpo këto sjelljet e kulturës dhe ndërgjegjësimit merren në fazat e shkollimit, mandej pjesa tjetër është sjellja e qytetarisë që çdo njeri duhet ta posedojë. Me siguri që togeri ka për të thënë diçka në këtë pikë.

**Toger, z. Besnik Qupeva:** Sa i përket prishjes së rendit dhe qetësisë publike, ne, në vazhdimësi jemi të angazhuar veçanërisht verës, ku tash edhe e kemi thurur planin operativ për sezonin veror i cili do të aplikohet pikë për pikë dhe besoj që ka me qenë një verë e mirë dhe me kaluar pa probleme. Lidhur me atë se sa biznese duhet të angazhojnë staf profesional, atë nuk mund ta them, por e di që në Klinëasnji biznes, hoteleri, kafene, nuk kanë sigurim privat. Vitin e kaluar kemi pasur pak incidente, sidomos te sheshi "Nënë Tereza", ndërsa pjesën dërrmuese të lokaleve i kemi pasur të qeta. Është ndonjëherë vetë ankesë nga vetë pronarët, të cilët e dinë rregulloren e komunës kur do të mbyllen lokalet, përveç kur kanë leje të veçantë kur ta prezantojnë, përndryshe policia është aktive që me orar lokalet duhet të mbyllen ose pason gjoba për mosrespektim të rregullores komunale. Po besoj që ka me kaluar gjithçka mirë dhe do ta gjejmë një bashkëpunim me pronarët e lokaleve edhe pse nuk kanë mbetur edhe shumë kafiteri, por edhe nëse ndodhë ndonjë incident, ne jemi këtu dhe do t'i trajtojmë në mënyrë profesionale.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Faleminderit, toger! Nëse ka dikush tjetër diçka ? Nëse jo, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

**Pika 3. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror dhe vërvshimet gjatë vitit.**

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Sezoni i verës sjellë me vete edhe rreziqe të shtuara nga zjarret, veçanërisht në zonat rurale dhe pyjore. Për të mbrojtur komunitetin nga këto rreziqe nevojiten masa të përgatitjes dhe vetëdijesimi që unë i kam cekë tri sipas planit: edukimi dhe informimi, trajnimi për reagim dhe monitorimi i zonave të rrezikuara. Ne të gjithë e dimë që në sezonin veror, uroj të mos ndodhin tek ne, ndodhin shpesh zjarrvënie të qëllimshme apo të paqëllimshme, megjithatë, është mirë përfshirja e moduleve të veçanta në programet shkollore dhe që trajnojnë çështjen e sigurisë, duke përfshirë sigurinë personale dhe publike, ndërgjegjësimi nga rreziqet e ndryshme dhe mënyrat e reagimit. Unë nuk e di tash dhe për këtë drejtori i Arsimit sigurisht që na kishte ndihmuar, por edhe në të kaluarën edhe deri vonë në shkollat tona ka pasur së paku një temë të ndërgjegjësimit nga zjarrvënia apo për mbrojtjen nga zjarri. Tash me siguri që janë të njëjtat, çdo shkollë ka aparatet e zjarrit dhe janë të trajnuara se si duhet të merren me to në rast që ndonjë rrezik ndodhë, por jam e sigurt që më mirë do të ishte nëse Elmia që është përfaqësues i zjarrfikësve, mund të na tregojë nëse kanë ndonjë plan në aspektin e përgatitjes së grupeve ose nxënësve të cilët do herë i quanim "ndihma e parë".

Tash, nuk e di edhe çfarë emri kanë në aspektin e përgatitjes së rasteve se si me u mbrojtur të paktën fëmijët.

**Z.Elmi Zenunaj:** Përshendetje! Kur të flitet për zjarrin, ne si operativ e kemi për obligim t'i themi nga dy fjalë. Në sektorin e preventivës që është marrë me këtë çështje me sensibilizimin e rënieve të zjarrit, që tri vite nuk kemi zyrtar te preventivës që zakonisht e ka bërë planin për shpërndarjen e disa fletushkave. Kanë shkuar në bashkësi lokale ku kanë biseduar me kryetarët e fshatrave, por tani për tani kemi mbetur kështu që sa kohë, megjithëse policia e ka një plan operativ për sensibilizim nëpër shkolla dhe ne si shërbim edhe pse nuk jemi të obliguar i bashkëngjatkemi dhe shkojmë nëpër shkolla për sensibilizim sado pak të njerëzve apo nxënësve për shkaqet dhe pasojat e zjarrit. Nuk e dimë pse ka zgjatur kaq shumë pa zyrtarë të preventivës, a janë procedurat ligjore, a çka, ne nuk e dimë, por ne jemi për operativ nëse paraqitet rasti.

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Faleminderit shumë! Procedurat tjera sigurisht që njerëzit kompetentë që janë ose drejtoritë përkatëse, sigurisht që e dinë ku është problemi, sigurisht është niveli qendror sepse edhe KLSP-të kanë mbetur pa u krijuar për shkak të mënyrës së pagesës dhe nëse më lejohet po ndërhy te kjo pikë sepse në një vendim që ka ardhur dhe që jemi duke u munduar me e zbatuar, vendimi ka ardhur që anëtarëve të KKSBS-së të ju kryhet pagesa.

Vendimin e kemi marrë prej kohës kur është bërë kontrata kolektive, jo më herët, gjithsej 6 takime të KKSBS-së që do të kryhet pagesa dhe ka mbetur vetëm diskutabile forma dhe mënyra se si me u paguar dhe jam e sigurt që gradualisht të gjithëve do të ju kryhet pagesa. Janë disa çështje burokratike që neve vet për anëtarët brenda KKSBS-së na ikin, ju të gjithë e keni parë që koordinatorja ka qenë pjesë e vazdueshme prej fillimit që jam unë. Orgeta ka qenë bashkë me ne dhe kur e marr e shoh vendimin, e shoh që kjo është jashtë asaj procedure. Do të thotë, kur të vjen koha të kryhet pagesa, Orgetës nuk i figuron emri për arsyen që unë nuk e di, të gjitha dokumentacionet që më janë kërkuar unë i kam përgatitur me kohë por që kjo ka qenë ajo që i ka përcjellë të gjitha e pikërisht është kjo që e ka problemi, por, që ne të gjithë jemi dëshmitarë që Orgetën e kemi pasur pjesë të KKSBS-së dhe besoj që edhe kjo do të rregullohet. Ka mundësi që dikujt pagesa i kryhet më herët, dikujt i kryhet më vonë, varësisht se si vjen renditja dhe mënyra se si e gjejnë mënyrën. Zyrtarja për Minoritete dhe Kthim e ka të lehtë sepse e ka drejtorinë dhe e ka buxhetin e vet në atë kuadër, kjo e kryen pagesën. Ju kërkoj shumë ndjesë nëse nuk paguheni që të gjithë përnjëherë, por të jeni të sigurt që të gjithë do të paguheni për aq kohë sa kemi qenë bashkë dhe duhet të dijë çdo njëri që në momentin që nuk ka qenë prezent pagesa nuk kryhet, sepse pagesa bëhet vetëm me nënshkrimin që kanë qenë prezantë këtu. Kërkoj ndjesë që ndërhyra, por kur ra tema te pagesat e KLSP-ve, këshillave të fshatrave, pse nuk po formohen ende, pikërisht është problemi sepse nuk kanë gjetur mënyrë (kod) se si me u kryer pagesa e tyre e me ligj është bërë se kryetari i një bashkësie lokale duhet me qenë me pagesë, por, që forma është ende problem. Po besoj që jemi të qartë dhe mënyra e pagesës së KKSBS-së në rregullore shkruante që është sipas rregullit të anëtarëve të asamblesë komunale.

**Z.Josip Dedaj:** Unë jam anëtar para vitit 2012 dhe vendimi për pagesa të KKSBS-së është marr në vitin 2012 një kohë. Ka këtu edhe persona që s'janë paguar, po flas në kohën e PDK-së edhe kur ka qenë Besim Hoti janë paguar, tash në çdo qeverisje kur po kemi problem te pagesa ja gjuajmë fajin qeverisë së kaluar. Këtu vendimet janë në 2012, në qoftë se paguhet për një anëtar qysh po thua ti, gjashtë takime nëse ka ligj këto duhet me u paguar për të gjithë anëtarët prej fillimit që janë anëtarë të KKSBS-së. Këtu nuk është çështje te pagesat edhe te formimi i këshillave lokale, bashkësive lokale. Unë që tri vjet me drejtorin e Administratës, z.Binak Sylaj kemi pasur takime dhe nuk janë formuar këshillat, e di që para zgjedhjeve kanë me u formuar se jam duke i parë lëvizjet, por këto gjëra të gjitha janë duke i bërë politike. Është mendimi im, ndoshta s'është ashtu, nëse paguhen për anëtarët e KKSBS-së ngadalë se bukur moti është kjo KKSBS e KLSP-të s'janë paguar hiç asnjëherë, unë jam anëtar para 2012 edhe kryetar i KLSP-së.

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Shumë në rregull, Josip. Vetëm ta sqaroj, Këshilli për Siguri në Bashkësi nuk e ka pasur problemin vetëm në komunën tonë, sepse unë jam duke u munduar të them diçka që unë e di se është. Unë i kam telefonuar rend komunat edhe nënkyetarët edhe ata që janë marrë me këto problematika i kam pyetur se si po e paguani KKSBS-në. Përgjigja ka qenë s'jemi duke e paguar se me ligjin e ri s'kemi të drejtë, dhe Josip si komunë jemi ndër të parët që jemi duke startuar me pagesa me këtë rregulloren e re që ka ardhur. Komuna e Klinës e ka një prioritet se takimet e KKSBS-së i bën pas orës 16:00 që e kemi diskutuar shpeshherë, pikërisht kjo e ka mundësuar që ne të mos kemi problem me pagesa, se në fund të fundit mundet me u paguar si punë shtesë dhe kaq për pagesën, se ne kemi punë të rëndësishme për sigurinë në bashkësi, sesa pagesa. Edhe pse në vende tjera më të zhvilluara ku i kanë pagat e mira s'kanë nevojë të presin prej KKSBS-së dhe këtë punë e bëjnë vullnetarisht, por, megjithatë një hap është bërë dhe uroj shumë që të paguhet edhe pjesa tjeter që aludoni që ka mbetur, por unë e ndjej obligim me i thënë hapat që kemi ardhur deri këtu, edhe për komunat tjera të siguroj që jemi me hapa të njëjtë sa i përket kryesuesve të KKSBS-së. Më falni nëse humbëm kohë me një temë që nuk është edhe e parëndësishme. Te vetëdijesimi për mbrojte nga zjarri harruam me cekë që nuk është problemi vetëm nga zjarrvënia, nga zjarri, janë problemet e vërvimeve dhe komuna jonë e di shumë mirë se në çka kemi kaluar dhe e besoj shumë që jemi të përgatitur dhe uroj që të mos ndodh, mirëpo, nuk është që nuk e dimë mënyrën si si duhet të reagojmë, por shpresojmë që të mos biem më në ato procedura.

#### **Pika 4: Plan i operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave.**

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Komuna e Klinës, pos përgatitjes së planit të drejtorisë përkatëse për pritje të mërgimtarëve për aktivitete për bashkatdhetarët tanë që vijnë, aktivitatet kulturore që na bëjnë t'i mirëpresim pjesën më të mirë të popullit tonë, familjarëve tanë, përgatitja e planit tjeter është nga organet e sigurisë sepse shumë mirë dihet se qyteti ynë është i

stërngarkuar edhe tash, por sidomos kur vinë edhe bashkatdhetarët shtohet numri i automjeteve, ngarkohet komunikacioni dhe dalin edhe probleme të tjera që jam shumë e sigurt që stacioni policor ka një plan të veprimit dhe e ka mënyrën se si të reagoj dhe se si t'ju dal në ndihmë bashkatdhetarëve por edhe qytetarëve, sepse nuk është që janë vetëm ata të atakuar, por jemi edhe ne, dhe po shpresoj që kanë një plan e së paku në komunikacion.

**Toger, z. Besnik Qupeva:** Ne, çdoherë e hartojmë planin për sezonin e verës, edhe për këtë verë e kemi hartuar planin operativ. Policët do të veprojnë në terren në bazë të atij plani dhe besoj që sezoni veror do të shkojë mirë. Ne e dimë që ka shumë njerëz dhe bëhet një komunikacion shumë i ngarkuar, në kafe tejkalojet pak më shumë orari i natës, por deri më tanë e kemi menaxhuar mirë dhe shpresoj që edhe këtë vit do ta menaxhojmë mirë.

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Faleminderit shumë, toger! Nëse ka dikush diçka lidhur me këtë temë, ne e dimë që parkingjet, trotuaret e qytetit janë goxha të ngarkuara dhe jemi të vetëdijshëm për këto probleme, megjithatë, kjo është çka mund të ofrojmë me këto kushte edhe vet po ballafaqohemi çdo ditë, por mendoj me një kujdes të shtuar, me respektim të rregullores së komunikacionit, do të ja dalim mirë dhe s'do rrezikojmë jetën e bashkatdhetarëve, as qytetarëve. Nëse ka dikush?

**Z.Josip Dedaj:** Unë desha të ndërlidhem te trotuaret, ndoshta diku dhjetë herë këtu e kam cekë se te rrathi "Mujë Krasniqi", rruga përballë shkollës fillore janë diku 32-33 biznese. Unë sot kam pasur takim me 3-4 persona dhe besoj që javën e ardhshme do të marr një peticion prej tyre.

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** M'fal, Josip, si quhet rruga?

**Z.Josip Dedaj:** "Dëshmorët e Kombit" te shkolla fillore "Ismet Raci". Ne e kemi një problem me parkingje, nënkyetare, ne bizneset nuk kemi ku ta parkojmë kerrin, unë kam ardhur në kadastër dhe më kanë thënë se parkingu është i objektit, do të thotë të atyre lokaleve që paguajnë tatim. A ka mundësi me bërë zgjidhje? Para zgjedhjeve në vitin 2009-2013 ka filluar me u asfaltuar rruga për Dresnik, u ndal rruga, u ndal trotuari, është vendosur ndriçimi deri ku ka trotuar, në pjesën tjeter nuk është vënë trotuari, as ndriçimi. Nuk e di a është Dresniku në territor të komunës së Klinës, a s'është askund, apo i kemi diçka borxh komunës. Pse janë ndërprerë punët në Dresnik edhe me u ndërprerë pikërisht ku fillon lagjja "Prenaj"? Është duke më ardhur shumë keq, znj. nënkyetare, po këtë do të ja them në takim edhe kryetarit. Me u ndërprerë aty asfaltimi, me u ndërprerë ndriçimi, cila është arsyaja? Sa e kanë pasur asamblistin e PSHDK-së, Tush Dedaj, në çdo takim e ka paraqitur rrugën e Dresnikut, dritat, trotuarin, çdoherë ju ka premtuar që po, por kurrë s'janë realizuar, viti i shtatë është ky, nënkyetare! Mua po më bie të dyshoj që është një problem shumë i madh, por këtë do ta them kur është aty edhe OSB-ja, edhe KFOR-i dhe të gjitha institucionet ndërkombëtare. Është duke u bërë një punë e qëllimshme me fshatin Dresnikë, një arkeologji që nuk e ka asnjë vend në Ballkan. Unë shumë shpejt do ta marr këtë zv.

komandantin ndoshta këtë javë, me parë se çka kanë bërë një operator me ekskavator me lumin në Dresnik , 3 m ka ardhur dhe ka punuar me ekskavator aty. A e ka marr lejen nga komuna, a çka ka bërë nuk e di, por me e parë është mjerim. Njerëzit dalin ecin me fëmijë dhe mund të bie ndonjë fëmijë aty, dhe po ju them se ajo çka është bërë, është bërë e qëllimshme. Do të thotë, komplet jemi bllokuar si fshat, asnje dalje nuk e kemi, se pse, përgjegjësitë le t'i merr komuna, faleminderit!

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Faleminderit, Josip! Rruga "Dëshmorët e Kombit" e the mes shkollës dhe lokaleve, parkingu thotë është i bizneseve. Kur pronari i lokalit thotë që parkingu është imi, si mund të ndërhyjë komuna aty?

**Z. Josip Dedaj:** Në hyrje te shkolla fillore ka qenë shenja shumë mirë "ndalim", përveç pronarëve të lokaleve aty është një rrugë dhe parkingjet janë drejtë me lokale.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** M 'fal, përderisa thua që është i lokaleve, atëherë është i yti dhe ti duhet ta mbrosh pjesën tënde, nëse është e komunës atëherë komuna duhet të dal në inspeksion.

**Hoxhë, z.Fitim Boja:** Josipi mund ta shpjegoj më mirë këtu, nuk është ky problem vetëm te Josipi, por te çdo dyqan në Klinë. Këta nuk paguajnë parking e kur se paguan s'mund të jetë i yti.

**Z. Josip Dedaj:** Me ardhur zyrtari i komunës, me parkuar kerrin në ora 08:00 deri në ora 16:00, e unë që jam tatim pagues i firmës, i lokalit, edhe ai që e lëshon qiranë paguan tatim edhe s'ka ku ta lë veturën, s'po di!

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Josip, mua veç po më intereson ta di, a mundem këtë temë ta adresoj te Drejtoria e Inspektoratit?

**Z.Josip Dedaj:** Shërbimet Publike dhe Inspektorati, unë e di që Shërbimet Publike e kanë, unë kam folur disa herë me Qëndrimin edhe më ka thënë se kemi me vendosur shenjën.

**Hoxhë, z.Fitim Boja:** Nënkyetare, kjo është sikur dyqanet që e paguajnë tarracën dhe për shembull Josipi duhet me paguar atë parking për me qenë i tij.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Po nëse ky do me thënë që është i imi, duhet ta paguaj, përndryshe çdo kush ka të drejtë ta lë veturën aty, mund të jetë edhe zyrtar i komunës.

**Z. Josip Dedaj:** Komuna s'është duke ndërmarrë asgjë. Ne na kanë thënë me vënë edhe një barrierë aty dhe me bërë me pagesë edhe ajo ka qenë zgjidhje, por unë kam me e këqyr vendimin a ka parking lokal, a s'ka, e në qoftë se s'ka, ne mund ta bëjmë parkingun, unë i paguaj për dy

automjete.

**Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj:** Veç ta sqaroj, nuk është ky problem, se unë jam duke e marr mendimin tënd e kam me zgjedhë, por me ditë ku është problemi. Përderisa thua është i një biznesi, atëherë është i biznesit, nëse ata e menaxhon komuna, aty ka të drejtë me u parkuar çdo kush.

**Toger, z.Besnik Qupeva:** Është pak më e komplikuar sesa e diskutojmë këtu. Për rastin konkret që jemi duke folur, për parkingjet mbrapa, prona është pronë publike dhe këtu kanë qasje të gjithë dhe me kthyer me bërë parking personal, ajo është kompetencë kommunale a mundet apo s'mundet me u rregulluar. Është mirë çdo vendim që merret, në kompetencë të kujt është, me marrë një vendim që nuk na ballafaqon vazhdimisht me qytetarët sepse për punë të parkingjeve nëse merret dhe ndahet privat si këtu që i kanë bërë te "Benita" ne i kemi eliminuar ato parkingje. Ai ka menduar me i bërë private por me kërkeshë të inspektoratit komunal ajo është pronë publike dhe nuk mundesh ti ta shndërrosh ta bësh personal parkingun, pavarësisht a e ke lokalini. Ne i kemi eliminuar dhe po flas nga përvoja që e kemi pasur më herët, inspektorët e kanë shqiptuar gjobën sepse ka bërë parkingje të paligjshme, është mirë me ju drejtuar kuvendit komunal se është mirë mos me krijuar gjëra që më vonë na sfidon me qytetarin në përditshmëri.

**Hoxhë, z.Fitim Boja:** Kjo është më shumë mirëkuptim mes biznesit dhe qytetarëve, për shembull te banesat e kuqe aty e kanë bllokuar me zinxhirë pa të drejtë.

**Toger, z.Besnik Qupeva:** Të njëjtin problem e kemi te të gjitha banesat kolektive, e kemi edhe te banesa e kuqe, e kemi edhe banesat e vjetra që janë të parat e qytetit, është një problem që nuk i takon policisë ta zgjidhë por është mirë njerëzit kompetentë me menduar qysh me zgjidhë, por jo me bërë diçka që më vonë do të na sfidojë edhe vet neve.

**Z.Josip Dedaj:** Kjo i takon edhe Policisë, Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Inspektoratit. Unë e kam parkingun para lokalit, e lë shumë mirë automjetin e autoshkollës, vjen tjetri edhe ta bllokoni daljen, nuk kthehet dy orë. Unë e kam thirr disa herë policinë, e kemi pritur deri kur është kthyer, e kemi pyet a është në rregull me lënë kerrin kështu, përgjigja ka qenë: jo veç pesë minuta. Unë po kërkoj zgjidhje e çka bën tash Drejtoria e Inspektoratit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike se di. Mua më ka thënë drejtori i Shërbimeve Publike se kemi me i ndarë edhe parkingjet edhe rrugën kemi me liruar, para 4-5 viteve unë tregova që shenja ka qenë edhe vinte policia e jepte gjobën ose e falte, vinte e largonte automjetin dhe shkonte, por ka njerëz që e lënë automjetin aty krejt ditën. Unë nuk e di ende tamam pronë e kujt është kjo, duhet edhe me kuvend komunal.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Ti duhet ta bësh këtë temë, duhet ta bësh kërkeshën në drejtorinë përkatëse dhe me e diskutuar. Nuk ka diçka të keqe këtu por edhe nuk është shumë e

lehtë, se pérndryshe ishte rregulluar deri tash, nëse është e nevojshme e thërrasim edhe këtu në KKSB dhe ju kthen përgjigje, por unë në mënyrën time mund ta sqaroj që biznesi është i yti, por parkingu është publik.

Pjesa tjeter e Dresnikut, pa drita, kuptohet që është një temë jo e folur, por e shumë folur. Më vjen keq që nuk ka zgjidhje sa i përket asaj që po thua është fshati i fundit, lagjja e fundit. Mund të ankohem edhe unë, se unë jam në rrugë kryesore, ende drita s'ka edhe mua më thonë qysh nënkyetare s'ke mundur me i sjell disa drita dhe unë s'besoj që mua ma kishin bërë me qellim, s'po di, megjithatë, po lypim drita unë e ti bashkë, Josip.

**Z. Josip Dedaj:** Dritat që 15 vite i ka vënë OSB-ja në Dresnik e rruga ende është në gurë, por problemi është se është ndalur trotuari dhe është shtruar rrugica e asamblistit tuaj, Kol Prenaj, e rruga kryesore nuk është shtruar.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Këto janë tema tjera, nuk po kthehem mbrapa, Silvia e ka fjalën.

**Znj. Silvia Rashkoviq:** Përshëndetje! IOM ka disa fshatra ku ka më shumë minoritete, me ministrin i kanë vendosur dritat dhe sa herë që prishen këto drita nuk rregullohen dhe shpeshherë kemi kontaktuar me drejtorin e Shërbimeve Publike i cili na ka thënë po, po, po, dhe tash një vit nuk është bërë asgjë.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Është detyrë e jona ta flasim të njëjtën temë, si me Dresnikun, si me fshatrat tjera! Uroj shumë të rregullohen, sa të mundemi me bërë, do të bëjmë, kaq mund të bëj ky këshill, me përcjellë një kërkësë te një anëtari të KKSB-së në vendin e duhur, pjesa tjeter mbetet te drejtorët e drejtorive e mundësive, unë po them e mundësive nuk po them vullnetit sepse besoj që vullnetin e kanë, por të mundësive për ta përmirësuar gjendjen. Përderisa janë vendosur aty dritat duhet edhe me pasur dritë, edhe pse shpeshherë e kam dëgjuar se ankesat e qytetarëve në zona të ndryshme që prishen, që intervenon se ne mbajmë edhe takime, borde etj në filan lagje i kemi rregulluar dritat, në filan vendi është raportuar dhe e kemi rregulluar, megjithatë, unë prapë do ta ngrehi këtë çështje në bordin e drejtorëve. A ka dikush tjeter?

**Hoxhë, z.Fitim Boja:** Tek pika e tretë, zakonisht zjarrvënia është faktori njeri dhe parapërgatitja dhe vetëdijesimi, këtu është edhe udhëheqësi i zjarrfikësve, mirëpo si parashihet me ligj është edhe togeri ndoshta ka ndonjë informacion, ndëshkimet për zjarrvënie dhe me pas marketing për shembull në ueb faqen e komunës, në Klina.info, pastaj po besoj që kishte me ndikuar shumë nëse ceket për ndëshkimet me para për shembull ose me mbajtje, kishte me qenë një prej faktorëve që ndikojnë në zjarrvënien e qëllimshme.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Faleminderit shumë, hoxhë! Me sa e shoh unë këtu, vjen prapë në pyetje Drejtoria e Inspektoratit dhe fjalë është për gjoba, por problemi është se ku

me zënë atë që e shkakton dëmin. Mirëpo te pjesa e ndërgjegjësimit dhe te pjesa e parapërgatitjes nuk kemi ndonjë mekanizëm që i ndërgjegjëson qytetarët, që mbledhim qytetarët, flasim apo mbajmë ndonjë trajnim. Kryesish kjo ndodh me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, por te pjesa që e thua me të drejtë por te dënim i është shumë problem me e gjetë zjarrvënësin. Unë vet personalisht kam marrë disa video dhe disa kërkesa që në filan rruge, filan vendi, ka depo mbeturinash të papara dhe nuk e kisha ditur që dikush ja bën vendit të vet ashtu, por, për t'i larguar është shumë problematike dhe nuk mundesh me i dit ata që shkojnë edhe i shkarkojnë ato mbeturina. Është vështirë me i identifikuar, sepse patjetër që kishte me qenë ide shumë e mirë dhe besoj që ishim vetëdijesuar pa pasur nevojë me mbajtur ligjérata.

**Z.Elmi Zenunaj:** Është një rregullore komunale e miratuar në vitin 2003-2004, është gjithçka e rregulluar rreth sanksioneve dhe dënlimeve rreth zjarrit dhe kemi mbi dhjetëra njerëz që janë zënë por që s'janë dënuar, dhe këtu është problemi te ne, se në teori jemi shumë të mirë, por në praktik jemi shumë keq. Nuk vetëdijesohen pa marr sanksione dhe nuk ka nevojë me shkuar në gjykatë se rregullorja komunale i rregullon sanksionet.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Këto të gjitha kërkohen nga komuna, ju e dini se komuna nuk ofron siguri, sensibilizimin po. Normal që diçka duhet me u bërë por shpresojmë dhe do të mundohemi për më të mirën.

**Toger, z.Besnik Qupeva:** Ndryshimet e kodit penal, ndryshimet e fundit, zjarrvënet i parashev si veprat penale që dënohen, ku ligji parashev sanksion për ta. Se a dënohen apo jo, ne nuk mund t'i ndërhyjmë gjykatës në kompetencat e saj, me rëndësi ne si institucion i sigurisë të marrim të gjitha veprimet e duhura për ta dërguar një kryes të veprës para drejtësisë. Aty e tutje nuk është kompetencë e jona, sensibilizimi është shumë i rëndësishëm, ndoshta e keni parë edhe në facebook që policia ka filluar me sensibilizim "festo me zemër, jo me armë" edhe për zjarrin gjatë verës besoj do të ketë fushata sensibilizuese, por kjo fillon nga komanda qendrore e policisë.

**Z. Elmi Zenunaj:** Në Gremnikë e kanë dënuar një të afërm timin, inspektorët regional. Jo ai, po më as fëmijët e tij nuk djegin më, edhe ata inspektorë rastësishët e kanë parë te ura duke djegur dhe janë ndalur e kanë dënuar, dhe pa i dënuar njerëzit është e kot.

**Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj:** Efekti i dënimit është ky. Mirë e tha edhe hoxha, se as Evropa nuk ka arritur me u zhvilluar pa i pasur këto sanksione. Ne, me rregull i kemi edhe më mirë se evropianët, por zbatimin e kemi problem, edhe unë jam i thitare që jo vetëm zjarrvënia, por gjithçka e dëmshme që nuk dënohet është keq, edhe një fjalë e qëllimshme që nuk dënohet është keq.

Nëse nuk ka diçka dikush tjetër, takimin po e përfundojmë me kaq.

Nënkyetarja e mylli takimin duke i falënderuar të gjithë që ishin pjesëmarrës.

Z.V. KRYESEUSJA,

ZV. KRYESESJĀ,



Процесмабастиеся,  
Оргета Сыла